

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6854
E martë, 21 mars 2023
çmimi 0.40 €

ARRATISJA E KRYEPROKURORIT SMITH

FAQE 6

Nga prof.
dr. Kudusi
LAMA,
gjeneral në
pension



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PROCESI GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-SË NIS MË 3 PRILL | FAQE 4-5

MBROJTJA: ZPS-ja PO GABON, UÇK-ja S'KISHTË ORGANIZIM TË MIRËFILLTË

- Specialja: ZPS-së do t'i duhen mbi gjashtë vjet për t'i paraqitur provat ndaj liderëve të UÇK-së



EPOKA
ERE

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së dhe ZPS-ja janë përplasur verbalisht të hënën rreth asaj nëse UÇK-ja kishte një organizim të mirëfilltë. Në pjesën më të madhe të kësaj seance përgatitore mbrojtja e Thaçit, e Veselit, e Selimit dhe e Krasniqit kanë argumentuar faktin

se si UÇK-ja nuk kishte një strukturë të organizuar dhe se roli i Shtabit të Përgjithshëm ishte i kufizuar dhe me pak ndikim gjatës luftës së viteve '98-'99. Ndërsa gjyqtari Charles Smith ka kërkuar nga ZPS-ja dhe nga ekipet e mbrojtjes që ta shkurtojnë kohën e

përcaktuar për paraqitjen e provave dhe të pyetjeve të dëshmitarëve teksa koha për nisjen e gjyqimit po afrohet. Ai ka thënë se, sipas numrit të dëshmitarëve, ZPS-së i duhen mbi gjashtë vjet për t'i përfunduar procedurat në këtë proces gjyqësor

ESCOBARI: ZBATIMI I MARRËVESHJES DUHET TË NISË MENJËHERË



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



GIRE SSE: KEMI AMBICIE PËR
KAMPIONATIN EVROPIAN | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KMDLNJ-JA MBËSHTET MARSHIN
"LIRIA KA EMËR": MARSHIMI PËR
DREJTËSI, I DOMOSDOSHËM | F. 5

FUNKSIONALIZOHET SHËRBIMI
I TERAPISË FIKSE ORTODONTIKE
NË QENDRËN KLINIKE
STOMATOLOGJIKE | F. 7

KUSH DO TË JETË PRESIDENT I
MALIT TË ZI? | F. 2

TË MËRKURËN DHE TË ENJTEN
KUVENDI MBAN SEANCË PLENARE | F. 7

EKONOMI



RAPORTI I INVESTIMEVE
I BEI-T: EVROPA TË NDËRMARRË
VEPRIME PËR T'I ADRESUAR
SFIDAT STRUKTURE | F. 8

Kush do të jetë president i Malit të Zi?

PODGORICË, 20 MARS - Millo Gjukanoviq ose Jakov Millatoviq do të zgjedhet president i Malit të Zi, për një mandat pesëvjeçar, në raundin e dytë të zgjedhjeve të planifikuar për 2 prill.

Ata fituan më së shumti vota në raundin e parë, të mbajtur të dielën, më 19 mars.

I pari, udhëheqës i Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS) dhe president aktual i shtetit, ka qenë në krye të politikës malazeze për më shumë se 33 vjet.

Tjetri hyri në politikë më pak se tri vjet më parë dhe është një nga drejtuesit e Lëvizjes Evropë Tani - parti e themeluar në qershor të vitit të kaluar.

Gjukanoviqi është 61 vjeç, Millatoviqi është 37.

Jakov Millatoviq

Ai hyri në garë zgjedhore pa planifikim, pasi kandidatura e Millojko Spajiqit, kryetarit të Evropës Tani, u refuzua për shkak të posedimit të nënshtetësisë malazeze dhe serbe. Ai ka diplomuar për ekonomi në Universitetin e Podgoricës, ka studiuar edhe në ShBA dhe Itali, ndërsa ka magjistruar në Oksford. Ka punuar në "Deutsche Bank" dhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ai e braktisi karrierën jashtë vendit për t'u vënë në dispozicion të Zdravko Krivokapiqit, kryeministrit të qeverisë së parë pas rënies së DPS-së, përbërja e së cilës u negociua në Manastirin e Ostrogut, nën përkujdesjen e Kishës Ortodokse Serbe.

Millatoviqi ishte një nga 12 "apostujt", siç i quante Krivokapiqi ministrat e tij.



Si ministër i Ekonomisë, Millatoviq, së bashku me Millojko Spajiqin, në atë kohë ministër i Financave, krijuan projektin ekonomik "Evropa Tani", me të cilin u hoq kontributi në shëndetësi dhe u rritën ndjeshëm paga minimale dhe të ardhurat mesatare.

Millatoviqi mbështet nismën e Ballkanit të Hapur dhe e cilëson Serbinë si "partneren më të rëndësishme tregtare dhe turistike". Ai e mbështeti edhe nënshkrimin e Marrëveshjes Themelore me Kishën Ortodokse Serbe, të cilën një pjesë e opinionit politik e konsideroi si tradhti ndaj interesave kombëtare, ndërsa ekspertët e konsideruan të diskutueshme nga këndvështrimi i Kushtetutës dhe karakterit laik të shtetit.

Si ministër, Millatoviq u konsultua me Mitropolitin e Kishës Ortodokse Serbe në Mal

të Zi, Joanikije, për shkallën e natalitetit.

Pas rënies së Qeverisë së Krivokapiqit, Spajiqi dhe Millatoviqi formuan partinë Evropë Tani në mes të vitit 2022, duke i dhënë asaj emrin e programit të tyre ekonomik. Në krye të partisë janë katër ministra "apostujt" të Qeverisë së Krivokapiqit.

Në zgjedhjet lokale në Podgoricë, në fund të tetorit të vitit 2022, DPS-ja humbi pushtetin dhe Evropë Tani, me mbështetjen e 21 për qind të votuesve, njoftoi se kryetar i ri i komunës do të jetë Jakov Millatoviq.

Gjatë konventës parazgjedhore të Millatoviqit në Cetinë, më 10 mars, ndodhi një incident gjatë protestës së qytetarëve, të cilët, sipas policisë, deshën ta pengojnë mbajtjen e saj. Të tubuarit mbanin pankarta me mbishkrimin "Po sikur të vdesin dhjetë malazezë", që

pretendohet se është deklaratë e Millatoviqit gjatë një proteste të mbajtur më 5 shtator të vitit 2021 në Cetinë, kur edhe u shugurua Mitropolitin e Kishës Ortodokse Serbe në Mal të Zi, Joanikije. Në atë kohë Millatoviqi ishte ministër në Qeverinë e Krivokapiqit, e cila miratoi ndërhyrjen e policisë në protestë. Dhjetëra njerëz u plagosën atë ditë.

Për raundin e dytë të zgjedhjeve, i pari që e mbështeti ishte Fronti Demokratik, parti pro serbe dhe pro ruse. Për Gjukanoviqin, Millatoviqi tha së voni se ai "ka vetëm një ideologji të përjetshme dhe ai është interesi personal dhe familjar".

Millo Gjukanoviq

Gjatë tri dekadave në pushtet, ai ishte dy herë president dhe gjashtë herë kryeministër. Gjukanoviqi ishte udhëheqës i

lëvizjes për rikthimin e pavarësisë së Malit të Zi në vitin 2006. Nën udhëheqjen e tij, Mali i Zi u anëtarësua në NATO në vitin 2017 dhe hapi negociatat për anëtarësim në BE në vitin 2010. Periudha e qeverisjes së tij u karakterizua me skandale të shumta rreth llogarive personale, kredive, kompanive jashtë vendit, financimit të paligjshëm të fushatës zgjedhore të DPS-së dhe me akuzat për shitje të burimeve shtetërore, krim dhe korrupsion.

Për atë periudhë, si drejtues i grupit kriminal, u dënua udhëheqësi i lartë i DPS-së, Svetozar Markoviq. Gjukanoviq ndërtoi marrëdhënie të mira me shumicën e vendeve të rajonit, me përjashtim të Serbisë, e cila u ftoh pasi Mali i Zi, kur ai ishte kryeministër, e njohu Kosovën në vitin 2008.

Ai e sheh nismën e Ballkanit të Hapur si një alternativë të keqe ndaj Procesit të Berlinit. Gjukanoviqi thotë se Shqipëria dhe Serbia, falë madhësisë së vendeve të tyre, po përpiqen që, përmes kësaj nisme, të krijojnë dominim në raport me vendet e tjera të rajonit. Sipas Gjukanoviqit, Kisha Ortodokse Serbe merret më shumë me çështje politike sesa fetare. Po sipas tij, ajo ka lidhje të ngushta me Kishën Ortodokse Ruse, patriarku i së cilës e bekon agresionin e Rusisë në Ukrainë. Ai, po ashtu, kujton se Parlamenti Evropian e ka cilësuar atë si një mjet për ndikimin e politikës malinje ruse në Ballkan.

Gjukanoviqi ka qenë në marrëdhënie të këqija me Kishën Ortodokse Serbe që nga miratimi i Ligjit për Lirinë Fetare në Mal të Zi në fund të vitit 2019.

Qeveria franceze përballet me mocion mosbesimi

Paris, 20 mars - Qeveria franceze do të përballet me dy mocione mosbesimi më 20 mars, në kohën institucionet po përballet me kritika për shkak të reformës kundërtënjësore për pensione.

Kryeministria e Francës, Elisabeth Borne, ka përdorur nenin 49.3 të Kushtetutës për ta shtyrë përpara projektligjin, pa pasur nevojë për votim.

Që kur kjo ngjarje ndodhi javën e kaluar, mijëra persona kanë protestuar në Francë. Mocionet e mosbesimit janë ngritur nga deputetët e qendrës dhe të ekstremist të djathtë, Tubimi kombëtar. Debati parlamentar do të mbahet më vonë gjatë të hënës.

Nëse kalojnë mocionet e mosbesimit, atëherë presidenti Emmanuel Macron nuk rrezikon të shkarkohet, por qeveria rrezikon të bjerë.

Macroni ose mund të emërojë një qeveri të re ose ta shpërndajë Parlamentin dhe të thërrasë

zgjedhje të reja.

Nëse nuk kalojnë mocionet, atëherë projektligji do ta rrisë moshën e pensionimit nga 62 në 64 vjeç.

Macroni ka argumentuar se popullsia e vjetër e Francës bën që skema aktuale e pensioneve e shtetit të jetë e papërbalueshme. Por, këtë mendim nuk e kanë të gjitha grupet parlamentare.

Aleatët e Macronit janë pakicë në Dhomën e Ulët të Asamblesë Kombëtare, por që të kalojnë mocionet, duhet të bashkohet e gjithë opozita.

Partia Republikane e Francës ka 61 ulëse dhe javën e kaluar lideri i kësaj partie, Eric Ciotti, tha se nuk do t'i mbështesë mocionet. Por, një zyrtar i lartë i kësaj partie tha se do të votojë për rrëzimin e qeverisë. Franca, përveç protestave, është përbalhur edhe me greva të punëtorëve të cilat pritet të vazhdojnë nëse rritet mosha e pensionimit.



Escobari: Zbatimi i marrëveshjes duhet të nisë menjëherë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 MARS - I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Kosova dhe Serbia menjëherë duhet të nisin ta zbatojnë marrëveshjen për normalizim të raporteve. Gjatë një diskutimi virtual me gazetarë, Escobar ka theksuar të hënën se pajtimi i arritur më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut është marrëveshje “në të gjitha aspektet” dhe është ligjërish e obligueshme, që do të jetë pjesë e rrugës evropiane e të dyja shteteve. “Rruga evropiane [e Kosovës dhe Serbisë] është jashtëzakonisht e kushtëzuar me zbatimin e kësaj marrëveshjeje”, tha ai.

Zyrtari i lartë amerikan tha se për Kosovën është e rëndësishme ta nisë draftimin e versionit të saj për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ndërkaq, për Serbinë tha se duhet të nisë t'i njohë dokumentet dhe simbolet shtetërore të Kosovës. “Kjo marrëveshje është nisja e pajtimit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ka shumë punë që duhet të bëhen përtej kësaj marrëveshjeje”, ka thënë ai.

Escobar e cilësoi marrëveshjen si “historike” dhe tha se do t'i ndihmojë partnerët evropianë që palët të mund t'i zbatojnë të gjitha pikat e marrëveshjes.

Zyrtari i lartë amerikan diskutoi edhe për faktin që as Kosova dhe as Serbia nuk e nënshkruan marrëveshjen gjatë takimit në Ohër. Ai theksoi se fokusimi në këtë aspekt është i parëndësishëm pasi, sipas tij, kjo është marrëveshje dhe shihet si e tillë nga BE-ja.

Escobar përsëriti se më 18 mars bisedimet nuk u përqendruan në arritjen e njohjes së ndërsjellë, por në normalizimin e raporteve. Megjithatë, ai shtoi se shpreson që shtetet mosnjohëse të BE-së ta njohin pavarësinë e Kosovës. “Ne shpresojmë që të gjitha shtetet e BE-së ta njohin Kosovën në një të ardhme të afërt. Është e rëndësishme për Kosovën, që

është pjesë e familjes evropiane, që të njihet nga pjesa tjetër e familjes evropiane. Besoj se një prej gjërave që duhet të ndodhë në rajon është se të gjitha shtetet në Ballkanin Perëndimor duhet ta njohin njëra-tjetrën dhe të kenë raporte paqësore dhe produktive”, është shprehur Escobar.

I pyetur se cili është modeli më i mirë evropian që mund të përdoret si shembull për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Escobar tha se kjo i përket popullit të Kosovës të vendosë në bisedë me Serbinë. “Por, ne besojmë se duhet të jetë një që u shërben interesave të popullit të rajonit, një që funksionon për të dyja palët, që lejon serbët etnikë të marrin pjesë plotësisht në jetën civile dhe demokratike të Kosovës, po ashtu duhet të jetë një asociacion që nuk shkel strukturën kushtetuese të Kosovës apo prek funksionalitetin e saj. Brenda kësaj ka shumë modele dhe shumë opsione dhe ne shpresojmë se do të kemi bisedime me të dyja palët që të mund të arrijmë jo vetëm të një opsion i përbashkët, por të një opsion atraktiv”, ka theksuar Escobar.

Borrelli këtë javë i njofton ministrat e BE-së për rezultatet e takimit të Ohrit

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, do të raportojë para ministrave të Jashtëm të shteteve të bllokut evropian lidhur me takimin në Ohër në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në këtë takim, që u zhvillua më 18 mars nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, palët arritën pajtim për aneksin për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve.

Këtë marrëveshje, apo siç njihet edhe si propozimi evropian, Kosova dhe Serbia e pranuan më 27 shkurt gjatë raundit të

bisedimeve që u mbajt në Bruksel. “Patëm diskutime të gjata dhe në fund edhe marrëveshje e cila do të konsiderohet si pjesë përbërëse e rrugëtimit evropian për të dyja palët. Do të bëhet pjesë e kapitullit 35 të negociatave të anëtarësimit me BE-në për Serbinë dhe pjesë e dokumenteve dhe kërkesave për normalizim për Kosovën. Tani do ta monitorojmë për së afërmi zbatimin. Të dyja palët janë shprehur se duan ta zbatojnë dhe le të shohim se si do ta bëjnë këtë”, tha më 20 mars Borrell para nisjes së takimit të Këshillit të ministrave të Jashtëm të BE-së.

Për takimin në Ohër të Maqedonisë së Veriut dhe për planet për ta siguruar zbatimin e asaj për të cilin u pajtuan palët, Borrelli do të flasë edhe në samitin e BE-së që zhvillohet në Bruksel më 23 dhe 24 mars.

Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, ka deklaruar se blloku evropian do të marrë vendim për zbatimin e marrëveshjes dhe aneksit dhe t'i bëjë pjesë përbërëse të komizës negociuese të BE-së për negociatat e anëtarësimit me Serbinë. Ndërsa për Kosovën, zbatimi do të jetë pjesë e Komisionit për Normalizim.

Një prej pikave të aneksit vendos zbatimin si kusht për përparimin e Kosovës dhe të Serbisë në procesin e integritetit në BE dhe flet për pasojat në rast se nuk do të ketë zbatim.

Marrëveshja drejt normalizimit të raporteve, që ka 11 nene, nuk përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë. Megjithatë, dokumenti kërkon nga të dyja vendet t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat. Kjo marrëveshje kërkon nga palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin Qeveria e Kosovës e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.

Blinkeni mirëpret marrëveshjen për zbatimin e propozimit evropian

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, mirëpriti pajtueshmërinë në mes të Kosovës dhe Serbisë për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve. “Përmbushja e obligimeve sipas Marrëveshjes Bazë, si pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm për pajtim, do të ofrojë mundësi të mëdha për njerëzit në dy shtetet dhe do ta përshpejtojë rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian”, tha Blinken përmes një deklaratë.

Kryediplomati amerikan përgëzoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për lidhshmërinë e treguar për arritjen e kësaj marrëveshjeje. “Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të jenë të angazhuara në mënyrë aktive, në

koordinim me partnerët e BE-së, për ta mbështetur Kosovën dhe Serbinë që të punojnë drejt një marrëdhënieje të parashikueshme dhe paqësore. Ne do të vazhdojmë ta mbështetim avancimin e stabilitetit dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor”, tha Blinken.

Kurti dhe Vuçiqi, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, më 18 mars u pajtuan për aneksin e zbatimit të propozimit evropian për normalizimin e raporteve. Në këto negociata, që u mbajtën në Ohër të Maqedonisë së Veriut, në cilësinë e vëzhguesit ishte edhe i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Bashkimi Evropian tha se palët në takimin e Ohrit nuk e nënshkruan zyrtarisht marrëveshjen, por u pajtuan ta zbatojnë atë. Kosova dhe Serbia ishin pajtuar më 27 shkurt për propozimin evropian për normalizimin e raporteve.

Si erdhi deri te marrëveshja?

Kosova dhe Serbia më 27 shkurt u pajtuan për marrëveshjen drejt normalizimit të raporteve, apo siç njihet edhe si propozimi evropian për normalizim.

Më 18 mars, palët, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, arritën pajtim për aneksin e zbatimit të marrëveshjes drejt normalizimit. Në rundin e dialogut, që u mbajt në Ohër të Maqedonisë së Veriut, në cilësinë e vëzhguesit ishte edhe Escobar.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka argumentuar se marrëveshja ofron “njohje de facto”, ndërkaq sa i përket Asociacionit ai i është referuar nenit 7, duke thënë se bëhet fjalë për “një nivel adekuat të vetëmenaxhimit të komunitetit serb” dhe “jo për vetëqeverisje”. Ndërkaq, presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se me këtë dokument formimi i

Asociacionit “është bërë detyrim me prioritet”.

Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe 2015. Marrëveshja e 2015-s, sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nuk është në përputhje me aktin më të lartë juridik të shtetit. Megjithatë, pikat mund të harmonizohen me ligjin. BE-ja së fundmi i ka dorëzuar Qeverisë së Kosovës disa modele evropiane për të drejtat e komuniteteve joshumicë, nga të cilat mund të merren shembuj për themelimin e Asociacionit. Qeveria në Prishtinë ka konfirmuar se është duke i shqyrtuar ato.

Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog nën ndërmjetësimin e BE-së dhe me mbështetjen e ShBA-së që nga 2011. Kosova kërkon që në fund marrëveshja ta përfshijë njohjen reciproke, kurse Serbia dëshiron një zgjidhje kompromisi.



PROCESI GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-SË NIS MË 3 PRILL

Mbrojtja: ZPS-ja po gabon, UÇK-ja s'kishte organizim të mirëfilltë

- Specialja: ZPS-së do t'i duhen mbi 6 vjet
për t'i paraqitur provat ndaj liderëve të UÇK-së

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së dhe ZPS-ja janë përplasur verbalisht të hënën rreth asaj nëse UÇK-ja kishte një organizim të mirëfilltë. Në pjesën më të madhe të kësaj seance përgatitore mbrojtja e Thaçit, e Veselit, e Selimit dhe e Krasniqit kanë argumentuar faktin se si UÇK-ja nuk kishte një strukturë të organizuar dhe se roli i Shtabit të Përgjithshëm ishte i kufizuar dhe me pak ndikim gjatës luftës së viteve '98-'99. Ndërsa gjyqtari Charles Smith ka kërkuar nga ZPS-ja dhe ekipet e mbrojtjes që ta shkurtojnë kohën e përcaktuar për paraqitjen e provave dhe pyetjeve të dëshmitarëve teksa koha për nisjen e gjykimit po afron. Ai ka thënë se, sipas numrit të dëshmitarëve, ZPS-së i duhen mbi gjashtë vjet për t'i përfunduar procedurat në këtë proces gjyqësor

**EPOKA
ERE**

Lirim GEÇI

HAGË, 20 MARS - Në Gjykatën Speciale të hënën është mbajtur seanca e fundit përgatitore për fillimin e procesit gjyqësor ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Procesi gjyqësor ndaj katër drejtuesve të UÇK-së do të nisë më 3 prill. Në seancën përgatitore, mbrojtja e liderëve të UÇK-së dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë përplasur rreth asaj nëse UÇK-ja kishte një organizim të mirëfilltë.

Në këtë seancë liderët e UÇK-së kanë marrë pjesë përmes videolidhjes. Ata janë duke u akuzuar kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, akuzat të

cilat i kanë mohuar qysh në paraqitjen e parë para Speciales në nëntor të vitit 2020.

Në pjesën më të madhe të kësaj seance mbrojtja e Hashim Thaçit, e Kadri Veselit, e Rexhep Selimit dhe e Jakup Krasniqit kanë argumentuar faktin se si UÇK-ja nuk kishte një strukturë të organizuar dhe se roli i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishte i kufizuar dhe me pak ndikim gjatës luftës së viteve '98-'99.

Ndërsa trupi gjyqësor i Gjykatës Speciale ka thënë se provat që do të paraqiten në proces gjyqësor nga ZPS-ja janë se të akuzuarit kanë qenë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që ka pasur kompetenca dhe përgjegjësi të rëndësishme, përfshirë disiplinën dhe

emërimet. Në këtë kontekst, avokati mbrojtës i ish-presidentit Thaçi, Gregory Kehoe, ka thënë se UÇK-ja nuk ka pasur një organizim të mirëfilltë. "Provat që ne do t'i paraqesim gjatë procesit, ju do të dëgjoni nga dëshmitarët zinxhirin e komandës në UÇK që ka qenë gjatë viteve '98-'99, që ka qenë kaotike, e ndarë në brigada më vete", ka thënë avokati Kehoe. Më tutje, mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka argumentuar faktin se si Zyra e Prokurorit të Specializuar ka bërë përkufizim të padrejtë në raport me funksionimin dhe funksionet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, duke thënë se UÇK-ja ishte një grup i armatosur joshitetor. Në këtë diskutim, avokati Kehoe ka përmendur si dëshmi edhe një

dokument të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), në të cilin thuhet se UÇK-ja nuk kishte një strukturë të organizuar.

Kurse avokati mbrojtës i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar ka përshkruar gabimisht UÇK-në si një organizatë që funksiononte me hierarki lart-poshtë. Emmersoni ka theksuar se, bazuar në provat që do të ofrojnë, do të dëshmohet se UÇK-ja nuk kishte organizim dhe se komandantët e Shtabit të Përgjithshëm nuk takoheshin rregullisht dhe në shumë raste nuk njihnin njëri-tjetrin. "Dy trupa gjyqësor të Tribunanit të Hagës janë mbështetur pak a shumë në të njëjtat prova që i ashtuquajturit Shtab i Përgjithshëm përbëhej nga një grup i shpërndarë individësh që nuk kishin ndonjë shtab të caktuar, madje nuk e njihnin njëri-tjetrin, dhe jo domosdoshmërisht e dinin cilët ishin anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë", ka thënë Emmersoni. Në këtë kontekst, Emmersoni u është referuar aktgjyqësive në rastet kundër Ramush Haradinajt dhe Fatmir Limajt në Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavi. Emmersoni ka thënë se nuk

bëhet fjalë për ushtri kur flitet për UÇK-në, duke cituar një ish-epor të UÇK-së, i cili, sipas tij, kishte deklaruar se "kam vendosur të jem komandant i atyre që një ditë vendosën të luftojnë".

Megjithatë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka thënë se provat dhe materialet e konfiskuara dëshmojnë se UÇK-ja ka pasur një organizim dhe strukturë udhëheqëse. "Provat tregojnë, edhe materialet që janë konfiskuara, se ka pasur një konsolidim dhe funksionim të hierarkisë së saj (UÇK-së). Shtabi i Përgjithshëm ka pasur kontroll mbi ushtarët e UÇK-së, por mënyra se si e ka ushtruar këtë kontroll ka ndryshuar me kalimin e kohës", ka thënë prokurori Matthew Halling.

Kurse një nga anëtarët e trupit gjyqësor i ka pyetur avokatët e liderëve të lidhur me ndalimin arbitrar dhe mënyrën se si mbrojtja po dëshiron ta orientojë rastin e saj si vetëmbrojtje. Përgjigje rreth kësaj çështjeje ka dhënë avokati i Thaçit, Luka Misiq. "A është synimi i ZPS-së që të tregojë se UÇK-ja nuk ka pasur autoritet të ndalojë persona, sepse atëherë kanë qenë në fuqi ligjet jugosllave? A kanë pasur të drejtë, sipas ligjit ndërkombëtar, edhe këtë nuk e kanë treguar. Cilat janë garancitë

KMDLNj-ja mbështet marshin 'Liria ka emër': Marshimi për drejtësi, i domosdoshëm

Prishtinë, 20 mars - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka njoftuar se mbështet marshin për drejtësi të ftuar nga iniciativa "Liria ka emër", që do të mbahet këtë të diel në orën 14:00 në sheshin "Zahir Pajaziti". "KMDLNj shumë herë ka reaguar kundër shkeljeve të shumta që iu janë bërë dhe po iu bëhen udhëheqësve ushtarakë dhe institucionalë gjykimi i të cilëve është paraparë të nisë më 3 prill 2023 dhe i konsideron të pafajshëm duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë i cili në mënyrë brutale është shkelur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhoma e Specializuar në shumë raste. Në këtë kontekst KMDLNj ka përkrahur dhe do ta përkrahë çdo protestë, demonstratë apo manifestim që

respektojnë rregullat demokratike në mbrojtje të të drejtave dhe drejtësisë të Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, si në diasporë ashtu edhe brenda vendit", thuhet në njoftimin e KMDLNj-së. Sipas këtij institucioni, në mungesë të përkrahjes institucionale në Kosovë, jo për të ndërhyrë në drejtësi, por për të siguruar një gjykim të drejtë, fer, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht nga grupet e interesit e që i obligojnë dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e personave të privuar nga liria dhe Kushtetuta e Kosovës, organizimi i marshimit për drejtësi nga platforma "Liria ka emër" mbetet reagim i qëlluar dhe i domosdoshëm qytetar në mbrojtje të të drejtave të Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri

Veselit dhe Rexhep Selimit dhe, si i tillë, do të përkrahë nga KMDLNj nga aspekti i të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria dhe respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë. "Drejtësia e paragjykuar nuk është drejtësi, është dhunim i të drejtave të njeriut dhe i standardeve ndërkombëtare për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar dhe, në këtë kontekst marshimi për drejtësi duhet t'i mbrojë këto vlera dhe këto standarde, prandaj është i domosdoshëm si ditën kur do të organizohet marshimi për drejtësi, deri në kohën kur do të realizohet drejtësia për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin përmes një gjykimi të drejtë, fer dhe të paanshëm, si vlera universale të të drejtave të njeriut

që garantohej nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut si dhe nga Kushtetuta e Kosovës!", është theksuar në njoftimin për medie. KMDLNj thekson më tutje se Dhoma e Specializuar apo Gjykata Speciale formalisht janë themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës kurse, faktikisht, me asgjë nuk ndërlidhen me institucionet e Kosovës, duke punuar në kundërshtim të plotë me mandatin që e ka në fushën e të drejtave të njeriut. "Realisht, Gjykata Speciale me Kosovën ka lidhje vetëm se i arretton dhe i dënon qytetarët e saj thuaja, së paku deri më tani 100 qind për qind shqiptarë. Është gjykatë që si fakt kryesor për arrestim dhe dënim

eventual e ka për bazë kriterin etnik pas së cilës përipiqet të sigurojë prova. Deri më tani, me dënime kapitale janë dënuar Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati si dhe Salih Mustafa. Po kjo gjykatë ka arrestuar ish-themeluesit e UÇK-së, bartësit e luftës çlirimtare sikur edhe bartësit e posteve më të larta institucionale në Republikën e Kosovës; Hashim Thaçin, ish-president, ish-ministër për Punë të Jashtme dhe ish-kryetar i PDK-së, Jakup Krasniqin, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës për dy mandate dhe u.d. i presidentit të Kosovës, Kadri Veseli, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës thuaja për dy mandate dhe ish-kryetar i PDK-së si dhe Rexhep Selimi, ish-kryetar i Grupit Parlamentar të IV-së dhe deputet i Kuvendit të Kosovës", është thënë, ndër të tjera, në njoftimin e KMDLNj-së.

MARSHOJMË PËR DREJTËSI



që një aktor joshetëror duhet t'u japë njerëzve që i mban në paraburgim? UÇK-ja në kohën e ngjarjeve që flitet këtu, kundërshtonte një shtet. A i ka dhënë ligji serb UÇK-së të drejta për të ndaluar? Ti mban përgjegjësi nëse dikush e ka vrarë dikë pa dijeninë tënde!", ka thënë avokati Misetiq. Në këtë debat është përfshirë edhe avokati i Veselit, Ben Emmerson. "Nuk ka dyshim se ekzistenca e UÇK-së gjatë vitit 1998-1999 si një grumbullim njerëzish që, thjesht, luftonin në kuptimin e gjerë, kishte për qëllim të mbronte vendin dhe qytetarët e vet kundër Serbisë. Ne pajtohemi me atë që tha Misetiq për ndalimin. Do të argumentojmë se nuk është shkelje e të drejtës humanitare ndërkombëtare apo krim që gjykohet në këtë juridiksion, për një grup joshetëror i armatosur që të ndalojë dikë që ka qenë luftëtar armik, që ka qenë civil që merrte pjesë në luftime, ose është një person bashkëpunëtor që dyshohet se i jep informacion

armikut. Këto nuk janë krime që njihen nga e drejta ndërkombëtare", ka thënë Emmersoni.

Specialja: ZPS-së do t'i duhen mbi gjashtë vjet për t'i paraqitur provat ndaj liderëve të UÇK-së

Në nisje të seancës përgatitore të së hënës, gjykatësi në rastin ndaj liderëve të UÇK-së, Charles Smith, ka kërkuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe ekipet e mbrojtjes që ta shkurtojnë kohën e përcaktuar për paraqitjen e provave dhe pyetjeve të dëshmitarëve teksa koha për nisjen e gjykimit po afron. Smith ka thënë se ZPS-ja ka paraqitur 312 dëshmitarë, që i bie 46 dëshmitarë në vit dhe për ta duhen 6.5 vjet për të përfunduar procedurat. "Është e tepërt koha që është kërkuar vetëm nga ZPS-ja për ta paraqitur rastin e saj. Edhe mbrojtja duhet ta shkurtojë kohën për t'i marrë në pyetje

dëshmitarët. Vetëm me dëshmitarët e prokurorisë me këtë ritëm duhen gjashtë vjet e gjysmë për t'i përfunduar", ka thënë Smithi. Megjithatë, përfaqësues të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) kanë thënë se janë duke bërë analizat e tyre për ta zvogëluar kohën e marrjes në pyetje. "Synojmë ta reduktojmë kohën e marrjes në pyetje për dëshmitarët. Jemi të interesuar të jemi sa më efikas. Askush nuk do që gjykimi të vazhdojë për gjashtë vjet e gjysmë. Jemi në dijeni për këtë. Për 150 orë pyetje të drejtpërdrejta kemi 11 dëshmitarë. Dëshmitarët e parë na japin informacion të rëndësishëm për të parë nëse mund të paraqesim dëshmitarë të tjerë me shkrim apo t'i heqim tërësisht. Kemi prova të mëdha për komunikatat e UÇK-së, dokumente nga të akuzuarit, dëshmitarët brenda dhe jashtë UÇK-së. Autenticiteti i komunikatave të UÇK-së po kundërshtohet nga mbrojtja", ka thënë një nga prokurorët e

Speciales. Ndërsa avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, ka deklaruar se bashkë me avokatët e tjerë do të punojnë që pyetjet e tyre të jenë sa më të shkurtra. "Ne do të flasim me ekipet e tjera të mbrojtjes dhe do të tentojmë mos të kemi përsëritje. Është një dëshmitar i rëndësishëm dhe varet nga përgjigjet e tij. Sa iu takon provave të reja që synojnë t'i paraqesin nëpërmjet këtyre personave, ne kundërshtojmë çdo provë të re që paraqitet që nuk na shfaqet paraprakisht neve. Shpesh ndodhin gjëra në seancën e gjyqit që janë jashtë parashikimeve", ka thënë Keohe. Hollësi lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve të parë ka dhënë edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson. "Për 12 dëshmitarët e parë koha është 25 orë e gjysmë pyetje për mbrojtjen e Veselit. Sigurisht jemi përpjekur të jemi sa më realë. Mund të shtojmë edhe pesë orë e gjysmë për dëshmitarin e dytë. Ne kemi dy vjet që u biem daulleve për kohëzgjatjen e procesit. Kemi

arritur në një pikë që prokurorisë i është dhënë hapësirë t'i paraqesë provat në rendin që i intereson të paraqesë. Ne do të tentojmë të zvogëlojmë sa më shumë kohën. Në momentin që do ta fillojmë këtë rrugëtim në këtë gjykim, dhe pavarësisht prej të dhënave që na ka dhënë Prokuroria, unë besoj se do të vijë koha kur trupi gjykues do të thotë po e teprojmë shumë. Kam kohë që e kam paralajmëruar këtë situatë", ka thënë Emmersoni. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë arrestuar nga Gjykata Speciale në fillim të nëntorit të vitit 2020. Që nga ajo kohë ata janë duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit në Hagë ndonëse disa herë kanë paraqitur kërkesë për t'u mbrojtur në liri. Në kalendarin e publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Speciale është bërë me dije se gjatë muajit prill, kur do të nisë procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, janë paraparë të mbahen katër seanca gjyqësore, më 3, 4, 5 dhe 11 prill. Të gjitha këto seanca do të fillojnë në orën 9:00.

Shpërndahen 400 pako ushqimore për familjet në nevojë në komunën e Gjilanit

GJILAN, 20 MARS - Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me organizatën "Qatar Charity", kanë shpërndarë të hënën pako ushqimore për 400 familje në nevojë. Kjo u bë e mundur pas memorandumit të bashkëpunimit që kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar

paraprakisht me drejtorin ekzekutiv të organizatës "Qatar Charity", Esam Dabab. Kryetari Hyseni, pasi ka falënderuar "Qatar Charity" për mbështetjen e vazhdueshme, ka thënë se këto pako po shpërndahen për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, për

personat me aftësi të kufizuara dhe nënat vetushqyese.

"Qatar Charity" ka mbështetur disa herë familjet me gjendje të rëndë sociale me pako ushqimore, ndërkaq me donacion të tyre po ndërtohet Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen Arbëria.



Fillon faza e dytë e rehabilitimit të lumit Llukac në Gjakovë

GJAKOVË, 20 MARS - Të hënën ka filluar faza e dytë e rehabilitimit të lumit Llukac dhe ndërtimi i shëtitorës përreth tij. Një projekt i gjatë 640 metra në vlerë prej 387 mijë eurosh. "Rehabilitimi i lumit Llukac dhe ndërtimi i shëtitorës përreth tij do të jetë një projekt tjetër fantastik në qytetin e Gjakovës i cili do ta marrë formën e tij brenda këtij viti", ka thënë kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini.

Ai ka theksuar se ata që e kanë parë projektin e lumit Krena e dinë se pas një pune të madhe, vjen diçka e jashtëzakonshme. "Ideja e këtij investimi është lidhja e lumit Llukac me lumenjtë Krena dhe Erenik si dhe rrugën 'Bujar Roka'. Një projekt

madhështor si ky do t'i dhurojë hijeshi Gjakovës dhe padyshim qytetarët tanë dhe të gjithë ata që vizitojnë komunën tonë do të kenë edhe një vend rekreativ për të kaluar një kohë kualitative. Këtë vit finalizohen faza e parë dhe e dytë e këtij projekti, konkretisht nga dalja për Prizren deri te hapësira prapa Sallës Sportive 'Shani Nushi'", ka thënë Gjini.

Ai ka bërë me dije se faza e parë është në kuadër të Programit Ndërkufitar IPA II Shqipëri dhe Kosovë me partneritet në mes të komunës së Gjakovës, Bashkisë së Kukësit, OJQ-së "SHE ERA" dhe OJQ-së "ACER". Ndërsa kjo fazë është investim i komunës së Gjakovës.



Bulliqi nënshkruan zotimin financiar për ndërtimin e Shkollës së Mesme Ekonomike

PODUJEVË, 20 MARS - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar zotimin financiar për ndërtimin e Shkollës së Mesme Ekonomike "Isa Boletini", e cila planifikohet të ndërtohet në kompleksin e shkollave të mesme në komunën e Podujevës.

Objekti aktual i Shkollës së Mesme Ekonomike do të shndërrohet në shkollë fillore me qëllim të lirimit nga ngarkesa që kanë shkollat fillore në qytet me numër të madh të nxënësve dhe hapësira të pamjaftueshme. Vlera për realizimin e projektit për ndërtimin e Shkollës së Mesme Ekonomike është rreth 2 milionë euro dhe planifikohet të përfundojë në vitin 2024.

Mjetet financiare për realizimin e punimeve në këtë projekt për këtë vit janë siguruar nga tejkjalimi i të hyrave vetjake të vitit



2022. Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të zotimit financiar

ishin edhe drejtori i Arsimit, Avni Fetahu dhe drejtori për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani.

Kryetari i Prishtinës: Qendra për trajtimin e qenve endacakë është në fazën finale të ndërtimit

PRISHTINË, 20 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar qendrën për trajtimin e qenve endacakë e cila është në fazën finale të ndërtimit. Ai ka thënë se ky objekt ka marrë formë dhe janë duke u përfunduar punimet e brendshme. "Me përfundimin e këtij objekti të gjithë qentë endacakë të identifikuar në territorin e kryeqytetit do të trajtohen,

vaksinohen, shërohen dhe kastrohen/sterilizohen në këtë qendër. Shumë shpejt do ta fillojmë edhe ndërtimin e Parkut të Kafshëve, me fokus në qentë me dhe pa pronarë, në një sipërfaqe prej 10 hektarëve në fshatin Slivovë. Ndërtimi i Parkut tashmë është në fazën përgatitore të procedurave të brendshme të domosdoshme për realizimin e tij", ka bërë me dije Rama.



Në parkun "Idriz Rreci" në Skenderaj dëmtohen pushimoret dhe lojërat e fëmijëve

SKENDERAJ, 20 MARS - Pushimoret, lojërat e fëmijëve dhe pjesë të tjera publike janë dëmtuar në parkun "Idriz Rreci" në Skenderaj nga persona të pandërgjegjshëm. Kjo gjendje ka nxitur reagimin e kryetarit të komunës së Skenderajt, Fadil

Nura, i cili ka thënë se, "pavarësisht prej përpjekjeve tona që me mish e shpirt mundohemi të krijojmë pak hapësirë për pushim, rekreacion dhe shëtitje, siç është parku i ri i përruruar javën e kaluar, për secilin që merr frymë në komunën

tonë, për fatin tonë të keq, ekziston gjithmonë dikush i cili dëfrehet me vandalizëm, deri në këtë nivel sa shkatërron pushimoret dhe lojërat e fëmijëve në Parkun 'Idriz Rreci' në qytet. Kushdo që ka mundur të shkaktojë këtë neveri do të japë llogari".



Të mërkurën dhe të enjten Kuvendi mban seancë plenare

PRISHTINË, 20 MARS - Të mërkurën dhe të enjten Kuvendi i Kosovës do të mbledhet në seancë plenare. Kështu ka vendosur Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur të hënën të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca. Në seancën e së mërkurës Kuvendi do t'i trajtojë pikat e mbetura nga seancat e kaluara, ndërsa të enjten do të mbajë seancë të re. Pas votimit të projektligjeve për

ratifikimin e tri marrëveshjeve ndërkombëtare, në Kuvend do të zhvillohet debat me kryeministrin Albin Kurti lidhur me bisedimet e fundit Kosovë - Serbi për të vijuar me shqyrtimin e Projektrezolutës për dyveçarim e Qeverisë Kurti II.

Në vazhdim pritet të votohet në parim për Projektligjin për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor, si dhe për atë për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158. Seanca do të vazhdojë me shqyrtimin e Propozimrezolutës për gjendjen në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe formimin e Komisionit Ah-hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar. Zgjedhja e tre anëtarëve të

Komisionit të Pavarur të Medieve do të jetë pikë e radhës e rendit të ditës për t'u pasuar me zgjedhjen e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve dhe një zëvendësi të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Në seancën e të enjtes pritet të shqyrtohen në parim edhe dy projektligje: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë



dhe ai për Organizimin e Tregut për Produktet Bujqësore. Pikë e fundit e rendit të ditës do të jetë themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje në Republikën e Kosovës.

Haradinaj: AAK-ja po fuqizohet çdo ditë e më shumë në mërgatë

PRISHTINË, 20 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbajtur takim me strukturën të AAK-së në Zvicër të Zvicrës. Ai ka thënë se prania madhështore në këtë takim është dëshmia më e mirë se AAK-ja po fuqizohet çdo ditë e më shumë në mërgatë. "Zvicra si vend mik yni ka qenë strehë për shumë shqiptarë në kohët më të vështira, ka qenë pranë nesh në periudhën shtetformuese e vazhdon ta ndihmojë Kosovën edhe tash në formë të ndryshme. Sot shqiptarët në Zvicër janë vlerë e çmuar dhe e respektuar për shoqërinë. Me vlerat që i

përfaqësojnë, përkushtimin dhe suksesin e treguar, janë shembull edhe për të tjerët. Liria që e gëzojmë sot ka rrënjët te përpjekjet dhe sakrificat e shumë brezave e cila kulmoi me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se kjo liri është edhe falë aleatëve tanë në krye me ShBA-në, të cilët i kanë dhënë krah Kosovës në kohët më të rënda. "Për Aleancën, marrëdhëniet me miqtë tanë, me ShBA-në në veçanti, janë jetike për rrugën tonë drejt anëtarësimit në NATO dhe në proceset e tjera eurointegruese. Përkrahja për Aleancën është për përkrahje

ndaj njerëzve me vlera atdhetare, të cilët kanë qenë gjithmonë në krye të detyrës në të gjitha periudhat kohore, si në përpjekjet për liri, por edhe në shtetndërtim", është shprehur Haradinaj.

Ai ka theksuar se AAK-ja në Zvicër në përbërje të saj ka njerëz të dëshmuar në shumë në lëmenj të ndryshëm. "Organizimi i mirëfilltë i tyre ka bërë që bashkatdhetarët tanë në mërgatë ta kenë adresë të tyre Aleancën, gjithë ata që besojnë në një Kosovë të fortë politikisht e me ekonomi të zhvilluar", ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.



Funksionalizohet shërbimi i terapisë fikse ortodontike në Qendrën Klinike Stomatologjike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar nga u.d drejtoreshë Narqize Arënlju-Hoxha dhe kryesuesja e bordit të ShSKUK-së, Aida Rexhepi, ishte i pranishëm në Klinikën e Stomatologjisë ku u shënuar "Dita Botërore e Shëndetit Oral" dhe filloi ofrimi i shërbimeve të terapisë fikse në Klinikën e Ortopedisë së Nofullave, shërbim ky që ka munguar në shërbimet stomatologjike publike në Kosovë. Ministri Vitia, po ashtu, pa nga afër punën që po bëhet në këtë klinikë në funksion të rritjes së kapaciteteve shëndetësore për

ofrimin e shërbimeve sa më cilësore shëndetësore në shëndetin oral.

Ministri Vitia u njoftua nga drejtuesit e klinikës për përgatitjet për fillimin e shërbimit të implantologjisë në Klinikën e Kirurgjisë Orale si imperativ i kohës, ku tha se, përveç që është obligim i MSh-së ndaj qytetarëve dhe kostos së lartë që paguajnë qytetarët për marrjen e këtyre shërbimeve, është edhe obligim ligjor për përmbushjen e kurikulës për shkollim specialistik. "Ju lus të llogaritni në ndihmën time për çfarëdo që varet nga unë si ministër që ky shërbim dhe shërbime të tjera siç është përdorimi i Oksidulit të Azotit në

procedurat stomatologjike, shërbim për të cilën tashmë jemi në finalizim të rregullativës ligjore dhe protokolleve klinike krahas kërkesës nga klinika juaj që ta vëmë në funksion që ky shërbim aq i domosdoshëm të bëhet i mundshëm për qytetarët tanë", ka thënë ministri Vitia me rastin e shënimit të Ditës Botërore për Shëndetin Oral.

Ministri Vitia ka mirëpritur prezantimin e planit zhvillimor të Klinikës së Stomatologjisë përmes të cilit parashihet që nga ky vit kjo klinikë ta fillojë punën në dy ndërrime duke mundësuar shërbime shëndetësore në periudhë më të gjatë ditore për qytetarët.

Kurti: Qeveria ka gjetur zgjidhje për të ofruar tekste shkollore mësimore në gjuhën turke

PRISHTINË, 20 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, vizituan shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Elena Gjika", në shënim të përvjetorit të mësimin në gjuhën turke. Të hënën u bënë 72 vjet prej se qytetarët e Kosovës patën mundësinë të mësojnë edhe në

gjuhën turke dhe me këtë rast kryeministri Kurti tha se ndihet krenar për këtë traditë kaq të gjatë të shumëgjuhësisë në vendin tonë dhe për mundësinë që fëmijët në Kosovë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Para stafit mësimdhënës të kësaj shkolle, kryeministri Kurti tha janë të lumtur që vjet qeveria ka gjetur zgjidhje për të ofruar tekste shkollore mësimore edhe të tilla, që janë cilësore në gjuhën

turke.

Po ashtu, ai përmendi edhe Strategjinë e Arsimit për vitet 2022-2026 që përfshin subvencione të vazhdueshme për hartimin, rishikimin, përkthimin dhe përshtatjen e teksteve mësimore dhe materialeve të tjera në gjuhën turke, por edhe në gjuhët e komuniteteve të tjera joshumicë që jetojnë në Republikën e Kosovës.



Raporti i investimeve i BEI-t: Evropa të ndërmarrë veprime për t'i adresuar sfidat strukturore



EPOKA E RE **FATON DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 MARS - Evropa duhet t'i rrisë ndjeshëm shpenzimet për investime produktive nëse dëshiron ta mbajë ritmin me konkurrencën globale dhe t'i arrijë objektivat për zero neto, thuhet në raportin e Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) 2022-2023.

Hendeku në investimet produktive midis Bashkimit Evropian dhe ShBA-së është gati 2 për qind e PBB-së, një prapambetje që ka vijuar për më shumë se dhjetë vjet. Raporti i Investimeve i BEI-t tregon se pjesa e firmave të përfshira në risi shënoi rënie vitin e kaluar krahasuar me vitin 2021. Bizneset përmendën pasigurinë, mungesën e aftësive dhe kostot e larta të energjisë si kufizimet kryesore për investime. "E ardhmja e Evropës varet nga aftësia jonë për të transformuar dhe përqaftuar tranzicionin digjital dhe të gjelbër. Kjo kërkon investime të guximshme si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Megjithatë, pasiguria, e nxitur nga politikat e paparashikueshme dhe kushtet e tregut, po rezultojnë në vendimet

për investime", ka theksuar shefja e Departamentit të Ekonomisë e BEI-t, Debora Revoltella.

Ajo ka shtuar se nuk mund ta humbasin mundësinë e tranzicionit të gjelbër. "Evropa mund ta shfrytëzojë avantazhin e saj të inovacionit në shumë teknologji të gjelbra dhe duhet ta shfrytëzojë më tej potencialin e tregut të përbashkët të BE-së, duke reduktuar pengesat administrative për investime dhe duke adresuar boshllëqet në aftësi", ka pohuar Revoltella. Të dhënat nga anketa e investimeve e BEI-t tregojnë se firmat në BE kanë më pak gjasa të fusin risi ose teknologji të reja sesa firmat në ShBA. "Ky është një hendek që ka vijuar, i cili u përkeqësua nga pandemia, kur firmat në Evropë treguan më pak gjasa për t'u transformuar sesa ato në ShBA. Investimi i pamjaftueshëm në inovacion, si dhe në makineri dhe pajisje mund ta rrezikojë aftësinë e Evropës për të konkurruar në afat të gjatë. Investimet e gjelbra nga kompanitë shënuan përparim në vitin 2022, pas një rënie gjatë pandemisë. Megjithatë, perspektiva për investimet e korporatave për t'i trajtuar ndryshimet klimatike është e përzier dhe e dobësuar

nga barrierat administrative e pasiguria.

Analiza e BEI-t për shtysat e investimeve të gjelbra nga firmat sugjeron se kjo pasiguri mund t'i tejkalojë pjesërisht stimujt e krijuar nga çmimet më të larta të energjisë", thuhet në raport.

Më tej theksohet se duke qenë se Evropa është pas ShBA-së në inovacionin digjital, teknologjitë e gjelbra janë një fushë në të cilën Bashkimi Evropian ka mbetur një lider i inovacionit. Në patentimin e teknologjive të gjelbra, pikat e forta të Evropës janë transporti, rrjetet inteligjente dhe energjia e erës. Megjithatë, ky përparim aktual mund të jetë nën kërcënim.

Në raport thuhet se konkurrenca globale rreth teknologjive të gjelbra po shtohet, veçanërisht me ligjin e ShBA-së për uljen e inflacionit dhe fokusin në rritje të Kinës në këtë fushë. "Ndërsa Evropa ka qenë një lidere në inovacionin e gjelbër deri më tani, ajo duhet të vazhdojë të punojë në këtë drejtim, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga tregu i saj i përbashkët. Korniza të qarta politikash, një fushë loje e barabartë brenda Evropës, investimet në aftësi dhe

përpjekjet e ndërgjegjshme për t'i plotësuar në maksimum masat e investimeve publike dhe private, të gjitha këto do të luajnë një rol", theksohet në raport.

Aftësitë janë thelbësore në tranzicionin digjital dhe atë të gjelbër. 69 për qind e bashkive të anketuara nga BEI deklaruan se u mungojnë aftësitë për vlerësimin e mjedisit dhe klimës që nevojiten për t'i çuar përpara investimet e gjelbra. "Pavarësisht mbështetjes për politika, kohezioni rajonal është gjithashtu në rrezik, ku rajonet më pak të zhvilluara në Evropën Lindore janë relativisht më të ekspozuara ndaj një kombinimi faktorësh stresues. Adresimi i aftësive lokale, kufizimeve fiskale dhe pengesave rregullatore do të jenë veçanërisht vendimtare për zbatimin e suksesshëm të Instrumentit për Rimëkëmbje dhe Qëndrueshmëri. Qeveritë duhet të ruajnë dhe forcojnë stimujt për një treg të përbashkët më të gjelbër dhe më të integruar, i cili është i mbrojtur mirë nga turbulencat, duke ofruar gjithashtu politika që ulin pasigurinë dhe u mundësojnë firmave të investojnë", thuhet në raportin e Bankës Evropiane të

Investimeve.

Raporti i Investimeve i BEI-t është raporti kryesor vjetor i Bankës Evropiane të Investimeve. I projektuar për të shërbyer si një mjet monitorimi, ai ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve dhe shtytësve të investimeve, si dhe të financimit të tyre në Bashkimin Evropian. Raporti kombinon analizën e brendshme të BEI-t me rezultatet e përfituara nga bashkëpunimi me ekspertët kryesorë për t'i shpjeguar tendencat kryesore të tregut dhe për të dhënë një vështrim më të thellë në një fokus të veçantë tematik. Botimi 2022-2023

pasqyron qëndrueshmërinë e ekonomisë së BE-së ndaj goditjeve të përsëritura dhe kapacitetin e saj për të ripërtërirë veten, duke përmbushur premtimin për investime produktive publike dhe private. Raporti përfshin rezultatet më të fundit nga Anketa vjetore e Investimeve të BEI-t, duke mbuluar përgjigjet e rreth 12 500 firmave në të gjithë Evropën ndaj një game të gjerë pyetjesh mbi investimet e korporatave dhe financimin e investimeve si dhe anketat e bashkive të BE-së.

Hoti: Rreth 2.5 miliardë euro të kursimeve pensionale të investuara në tregje financiare janë në mëshirë të fatit

PRISHTINË, 20 MARS - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se tani po ndihen pasojat e mungesës së bordit të trustit, pasi ky institucion ka mbetur pa bord nga 1 marsi. Ai ka thënë se rreth 2.5 miliardë të kursimeve pensionale të investuara në tregje financiare janë në mëshirë të fatit. "Pasoja tanimë po i bartim. Çmimi i njësisë së FKPK-së është në rënie nga 3 mars 2023 e këndej. Kjo po ndodh për shkak të disa sinjaleve për krizë të


mundshme në tregjet financiare nga falimentimi i një banke në ShBA. Por, në mungesë të Bordit, nuk ka kush të marrë vendim për tërheqje të investimeve të Trustit Pensional nga tregjet financiare ku ka rënie. Kjo është papërgjegjësi. Mandati i anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional ka mbaruar më 30.11.2022, por është zgjatur edhe për tre muaj. Konkursi është shpallur para tre muajve më 02.12.2022, por deri më tani asnjë veprim nuk është ndërmarrë. Konkursi do të

duhej të ishte shpallur disa muaj para se të mbaronte mandati i Bordit, në mënyrë që të kishte kohë të mjaftueshme për të zgjedhur Bordin e ri", ka shkruar në "Facebook" Hoti.

Ai ka thënë se, përveç kësaj, në mungesë të bordit, kursimet e mbledhura nga Trusti gjatë këtyre muajve nuk do të mund të investohen në tregje financiare. "Mazhoranca që qeveris me vendin e ka refuzuar projektligjin për tërheqje të mjeteve nga Trusti. Si do të përgjigjet tani!?", ka pyetur Hoti.



ARRATISJA E KRYEPROKURORIT SMITH



Nga prof. dr. Kudusi LAMA, gjeneral në pension

Kryeprokurori i Gjykatës Speciale, e quajtur e Kosovës, me seli në Hagë, ka dhënë dorëheqje nga detyra, duke u ngarkuar me një detyrë tjetër - këshilltar për prokurorët që po e hetojnë veprimtarinë e ish-presidentit të ShBA-së, Donald Trump. Domethënë, ai u emërua në një detyrë formale, thjesht për të mos u deklaruar se u arratis i turpëruar nga detyra e tij në Hagë.

Por, vërtet, a u arratis prokurori Smith?

Vetëm kush nuk do ta shikojë të vërtetën nuk e kupton këtë arratisje të turpshme!

Të vish nga ShBA-ja, ta bësh të fortin e pathyeshëm, të krijosh idenë se je ai që do të punosh për të vendosur drejtësi si në ShBA, të pretendosh se veprimtaria jote mbështetet nga ShBA-ja, që janë miku, mbrojtësi e mbështetësi i parë i të drejtës për liri dhe pavarësi të Kosovës, dhe krejt papritur të gjendesh si bashkëpunëtor i prokurorisë serbe, duke mashtruar, përpunuar e krijuar shpifje kundër burrave shqiptarë të luftës çlirimtare të Kosovës, që janë marrë peng në Hagë, ky është turpi më i madh që mund të bëjë një burrë, kushdo qoftë ai!

Dhe, turpi është aq më i madh për aq sa je i dukshëm në sytë e qytetarëve të botës. E zotëri

prokurori Smith u duk para gjithë botës si një sahanlëpirës që e turpëroi veten, duke u vënë në shërbim të një institucioni kriminal, siç është prokuroria e Serbisë, e cila burrat që prokurori Smith i ka marrë peng, i ka dënuar me dënim maksimal në vendin e tij dhe me ligjet e tij. Prokurori Smith bëri përpjekje që me ligjet e Serbisë t'i dënojë çlirimtarët shqiptarë, përsëri për arsyen e vetme: se ashtu ka dëshirë padroni i zotëri Smith-it.

U arratis kryeprokurori Jack Smith duke e lënë detyrën që e mori me aq mburrje, vetëm se i doli e vërteta që e damkosi si të shitur, si mashtrues, si abuzues në emër të ligjit, si djallëzor duke u mbështetur te qenia qytetar i ShBA-së, si mbështetës i denoncimit të të pavërtetave, si kundërshqiptar për interesat e tij personale, si akuzues me porosi të Serbisë - armikut dhe masakruetit të shqiptarëve, si paragjykes dhe mashtrues për të dëmtuar shqiptarët me urdhra të punëdhënësit të tij - prokurorisë së Serbisë. I doli boja dhe u bë me turp sepse shiti trupin dhe shpirtin e tij te një institucion gjakësor.

Mund të fitosh shumë pasuri me mënyra të turpshme, siç bëri prokurori Smith, por nuk

mund të jesh njeri për të të respektuar njerëzit e thjeshtë, e në këtë çast, ka përfunduar gjithçka nga njerëzia për të cilën është e interesuar shoqëria njerëzore liberale.

Me germa të mëdha mediet shkruanin,

"Prokurori amerikan, Jack Smith, është vendosur në postin e kryeprokurorit në Dhomat e Specializuara ku hetohen pretendimet për krime të luftës në Kosovë"! Dhe të gjithë thoshim: Kjo është mrekulli, sepse ne borxh nuk i kemi askujt, u krijua një pretekst për të hetuar luftën çlirimtare të Kosovës dhe luftëtarët e saj për krime lufte, por krime nuk ka, prandaj edhe deshi fati që të vijë një prokuror nga ShBA-ja për t'i hetuar këto të quajtura krime, dhe ai do të bëjë drejtësi. Të gjithë i kanë besuar qenies qytetar i ShBA-së të këtij prokurori, se do të bëjë drejtësi. Por askush nuk ka menduar se ai do të bëjë padrejtësi dhe jo thjeshtë padrejtësi, por padrejtësi të pistë me bashkëpunim kriminal me masakruetit e shqiptarëve. E, të bësh drejtësi me masakruetit e shqiptarëve, për t'i gjykuar ata, se nuk ka mundur t'i zhdukë masakruetit që i ka dënuar me burgime maksimale, por nuk ka arritur t'i zërë për t'i futur në burg, ky

është akti më masakruetit, që bëhet nga një qytetar amerikan, i cili pasi i del në shesh poshtërsia arratiset nga vendi i punës, për të zënë një punë të pavlefshme, por thjesht vetëm për t'u fshehur diku. Nuk është çudit nëse atë vend pune e ka blerë me paratë që i ka dhënë Serbia për shërbimet që i ka bërë, duke marrë peng burrat luftëtarë të Kosovës!

Amerika ka juristë të zotë me shumicë, zotëri Smith të mos të kujtojë se mendon dikush, se ishte ai më i domosdoshmi për të qenë këshilltar në atë grup pune për të hetuar se ku e si i ka mbajtur dosjet e dokumentet presidenti i ShBA-së. Jo zotëri, ti përfundimisht u bërë me llum dhe llumi prej këtej ka për të të mbuluar gjithë jetën, por për fat të keq, shqiptarëve u shkaktove shumë dëm, duke u rreshtuar me pushtuesin dhe masakruetit e tyre, duke u rreshtuar me Serbinë, që ka bërë krimet më të rënda kundër shqiptarëve, si asnjë pushtues tjetër në botë.

Jam i sigurt se edhe atje ku e kanë dërguar për ta fshehur do ta bëjë ndonjë pisllek, se këtë portret ka, portret për të prodhuar pislleqe. Por atje nuk duhet shkuar me mendimin e Hashim Thaçit, që besoi sinqerisht në drejtësinë e tij dhe e la gjithçka në dorë të tij.

Atje ka përballë Donald Trump-in që do t'i bëjë atë, që nuk do të gjej më vend ku të fshihet.

Prokurori Jack Smith, i cili ishte kryeprokuror i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Gjykatën Speciale për krime lufte në Kosovë, me seli në Hagë, i cili duke dhënë dorëheqje nga hetimi i akuzave me të cilat ngarkohen udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët janë marrë në paraburgim, duke ikur pa e filluar gjykimin, kuptohet që iku për të qenë sa më larg krimit të tij. Sepse, duket se ishte gjetur një kriminel për të hetuar një krim të paqenë.

Prokurori i kriminalizuar tashmë i arratisur, Jack Smith, pa e vrarë ndërgjegjja e tij, nëse ka ndërgjegje, nxori nga kasaforta dokumentet sekrete, për të cilat u tha se rrodhën, por që nuk kuptoj si mund të rrjedhin dokumentet nga kasaforta dhe të mos mbaj përgjegjësi askush!? E, ato dokumente që rrodhën u sollën pranë zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës në Prishtinë, për të marrë në burg e për t'i dënuar krerët e kësaj organizate, Hysni Gucatin e Nasim Haradinajn, dhe pa akuzuar askënd, se si dolën dokumentet dhe si erdhën deri në Prishtinë. Për këtë ky lloj

prokurori nuk pati guximin të hetojë kurrë, sepse gjithçka e ka organizuar dhe realizuar vetë, thjesht vetëm për të gjetur një pretext të arrestonte burrat, që trembej, se mund t'i nxirrte probleme, kur të kryente krimin tjetër të radhës, siç ishte marrja e krerëve të shtetit si të akuzuar në burg.

Që në fillimet e kësaj detyre ky prokuror ka bërë deklarata paragjyquese: Së pari, duke vlerësuar se kjo gjykatë është "mundësia që Kosova t'i lërë pas problemet e luftës", çka nënkupton se lufta çlirimtare duhet zhvlerësuar, për ta bërë të tejkualuar dhe të panevojshme; Së dyti, duke ngritur akuzën se "ekziston një grup i fuqishëm njerëzish në Kosovë, të cilët nuk e duan ekzistencën e kësaj gjykate dhe të cilët do të bëjnë gjithçka për ta dëmtuar...", është tregues i papërgjeshmërisë së tij paragjyquese, kur dihet se ata që ai zotëri i akuzon për dëmtim të asaj gjykate janë vetë krijuesit e saj, sepse ajo gjykatë është krijuar me votat e parlamentit të Kosovës; Së treti, duke e deklaruar pa u shqetësuar paragjykimin e

dyfishte se, në Kosovës punohet "... për ta shpëtuar idenë e rreme se asnjë ushtar i UÇK-së nuk ka kryer krime gjatë luftës", çka tregon se ky zotëri e ka të paracaktuar programin, si disa policë të qarkullimit rrugor, që dalin me paramendim për të vënë gjoba shoferëve në rrugë, apo si disa spiunë të paafte në kohën e diktaturës në Shqipëri që për të bërë karrierë duhej të zbulonin ndonjë "armik të shtetit", prandaj edhe ky zotëri deklaron se do ta zbulojë atë që i intereson, si dhe akoma më keq, kur pa filluar akoma puna, deklaron se ideja e pastërtisë së luftës çlirimtare është ide e rreme, një guxim ky që realisht po të kishte drejtësi në atë moment kur paragjykon pa filluar puna, duhej shkarkuar nga detyra; Së katërti, ai duket se i vë kushte e kufizime edhe gjykatës, kur shprehet se "..., çështjet e paraqitura nga zyra që unë drejtoj dhe faktet që do të dalin në dritë nga gjyqet e zhvilluara në këtë sallë nuk do të lënë asnjë dyshim se kjo ide nuk është e vërtetë. Por, kjo ide e rreme është aq e rëndësishme sa që disa udhëheqës të caktuar

të UÇK-së do të bëjnë çmos, gjithçka që të pengojnë daljen në dritë të informacioneve që tregojnë se kjo është e vërtetë", prej ku shihet tendenca për ta diktuar punën e gjykatës, pasi drejtësi, sipas kësaj logjike është gjithçka që dëshiron të arrij ky zotëri; Së pesti, zotëri Smith bën edhe lojë fjalësh, kur deklarohet se zyra e tij "... nuk ngre akuza ndaj UÇK-së as luftës së bërë për pavarësi", por duke e quajtur këtë ushtri ndërmarrje e përbashkët kriminale.

Tashti unë nuk di se si mund të veprohet ndryshe për të kriminalizuar UÇK-në dhe luftën e saj për çlirim? Ky zotëri është aq i paskrupullt sa të deklarojë se këto gjyqe nuk janë kundër popullit të Kosovës, sepse "fakti që populli i Kosovës vendosi ta krijojë këtë institucion përbën dëshmi për angazhimin e shtetit ligjor", pra ai luan edhe me faktin që kjo gjykatë u krijua nga parlamenti i Kosovës dhe u krijua me këmbënguljen e atyre që ai i ka arrestuar pa aktakuzë; Së gjashti, për ta bërë çështjen sa më interesante, këmbëngul që krerët e shtetit të Kosovës të

arrestuar të mbahen të burgosur sepse "ekziston rreziku për arratisje, shkatërrim, fshehje, ndryshim provash të një krimi", dhe e gjithë kjo për të krijuar idenë e rreme se ata burra i ka arrestuar ky zotëri në flagrancë, sikur nuk u paraqitën vetë këta në këtë gjykatë, por ai që e ka mendjen vetë të arratiset, siç u arratis me mandat shtetëror të ShBA-së. Megjithëse prokurori Smith shkon me mendimin se do të jetë i vlerësuar, pasi ka lënë pas vetes një çorbë derri, që e di mirë se shqiptarët thjeshtë do ta neveritin, se për fat të keq, ne nuk jemi hakmarrës, pasi do të duhej ta ndiqnim edhe atje ku ka vajtur, për ta detyruar me të gjitha mënyrat e kohës moderne, të tregojë të vërtetën pse bëri gjithë ato përpjekje, për t'i vënë shqiptarët kundër njëri-tjetrit, për të krijuar probleme, që të krijohet mendimi se UÇK-ja nuk ka luftuar me serbët pushtues, por me shqiptarët.

Po kështu, ai e solli çështjen e kësaj gjykate në atë mënyrë që të krijohen përçarje edhe brenda politikës shtetërore në Kosovë. Jam i sigurt se po të

kishte bërë një vepër të tillë kundër ShBA-së tani do të ishte në burg, pavarësisht se thirret se ShBA-ja po e vlerëson se i ka ofruar një punë si këshilltar diku. Por kjo nuk ka ndodhur për hatrin a vlerësimin e tij, nëse nuk është vepër e ndonjë të njohurit apo të paguarit të tij. Këtë ShBA-ja e bën se nuk do të vihet në pozicionin e akuzuesit të luftës çlirimtare të Kosovës, të cilën e mbështeti dhe e ndihmon me shpirt e bindje për të drejtën dhe të vërtetën. Megjithatë, unë kam një bindje se lufta dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës do ta shkundin edhe këtë llum që i lëshoi mbi shpinë zotëri Smith. Prandaj, nuk do të kisha dëshirë të largohej duke u arratisur siç veproji. Do të doja që ai të ishte aty si dështuar, para të vërtetës e të drejtës dhe i akuzuar për çka ka bërë. Por ky zotëri e di përfundimin, prandaj edhe u arratis. Po të kisha diçka në dorë nuk do ta kisha lënë të largohej. Pasi ky zotëri ka ikur, si ndonjë komandant fronti në vijim të operacionit, që i lë trupat në luftim dhe ikën nga sytë këmbët. Dhe këtë e bën se shikon dështimin e



operacionit, për të thënë nesër që, po të isha unë aty, ky operacion do të kishte përfunduar me fitore. Kjo është realisht “fitore” e të dështuarit, “fitore” e frikacakut, e të korruptuarit, e të shiturit, e njeriut pa ideale profesionale, e tradhtarit të çështjes që pretendon se i është kushtuar. Kështu veprimi me arratisjen e tij prokurori Smith, sepse e pa dështimin dhe duke ikur i lind e drejta të thotë nesër që, po të isha unë aty, përfundimi do të ishte ndryshe.

Dhe përfundimisht, ai dështoi edhe me figurën që bëri përpjekje të ndërtojë, duke vënë gishtin mbi luftëtarët e UÇK-së, për t'u prezantuar si njeriu që i kishte zënë kriminelët, kishte zënë ata që grabitën organe të njerëzve, që vranë si e sa deshën, por që koha tregoi se ai kishte mashtruar. Çfarë do t'u thotë atyre që i trajtoi si viktime, të cilët i la në rrugë pa krye, sepse vendin e tyre e humbën duke shpifur sipas instruksioneve të tij e rrugën për më tej nuk e shohin sepse ai që ishte pishtari i tyre, pra prokurori Smith, u arratis? Më vjen keq për të gjithë ata që u mashtruan e u shtirën si viktime duke akuzuar udhëheqësit e luftës për çlirimin e atdheut tonë.

Kryeprokurori Smith filloi ta përgatisë arratisjen e tij, që kur deklaroi se “në Kosovë ka njerëz që do të bënin gjithçka për ta dëmtuar Gjykatën Speciale”. Ndërsa duhet kuptuar se në Kosovë nuk ka të tillë, por ka nga ata që duan gjykatë drejtësie, jo gjykatë politike, apo mafioze, siç kishte dëshirë ta poziciononte ky prokuror. Në Kosovë janë ata që e ngritën me votën e tyre këtë gjykatë. Ashtu edhe të grabiturit e të mbyllurit në paraburgim në Hagë prej këtij prokurori, e kanë votuar ngritjen e asaj gjykate, sepse janë të bindur se janë të pafajshëm dhe në të drejtën e tyre, pavarësisht se ishin përpara një njollosësi të historisë së shqiptarëve, i cili i tmerruar nga dështimi, u arratis.

Ky prokuror, që shfrytëzoi votën e udhëheqësve të luftës për drejtësi, bëri padrejtësinë më të paprecedentë, duke i dhënë vetes të drejtë të akuzojë dhe të arrestojë këdo që dëshironte. Kështu, prokurori Smith, publikisht e politizoi këtë institucion të drejtësisë dhe në vijim e privatizoi, duke e vënë të punojë sipas dëshirës së tij, për interesat e tij. Koha do të tregojë për këto, por uroj që ai i cili i shkaktoi pa asnjë arsye, një ditë të japë llogari para ligjit si i pandehur.

Ashtu sikurse dihet, se siç ka ndodhur edhe në gjyqet e mëparshme kundër luftëtarëve të UÇK-së të akuzuar për krime, kur të akuzuarit e radhës do të përfundojnë duke u shpallur të pafajshëm, ky zotëri ka për të pretenduar se janë “frikësuar dëshmitarët”, se janë “prishur provat”, se nuk janë

studiuar si duhet “dokumentet” etj.

Por ai nuk do ta përmendë kurrë se arrestimin e bëri mbështetur në ato thashethemet e preferuara të tij “trafikimin e organeve” nga luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Akuza të cilat prokurori Smith, megjithëse e dinte se ishte arritur në përfundimin se nuk ishin të vërteta, nuk i hoqi nga agjenda e tij deri kur arrestoi e futi në burg disa prej udhëheqësve të luftës së UÇK-së.

Dhe, e gjithë kjo për të deklaruar botërisht se edhe shqiptarët kanë bërë krime, aq më keq, krimet të tilla si “trafikimi i organeve”, për të cilat nuk ishte akuzuar as Serbia. Pra, duhej pranuar, sipas prokurorit Smith, se krimet jo vetëm që ishin bërë edhe nga shqiptarët, por luftëtarët e lirisë kishin shkuar edhe më tej duke bërë “trafikim organesh njerëzore”. Kështu që, shqiptarët ishin fajtorë si serbët, e më shumë se serbët. Por, që të mund të fitohej kjo betejë, duhet të vihej në pa se luftëtarët, në radhë të parë dhe më së shumti kanë “vranë shqiptarë”, të cilët janë etiketuar për përfitime politike. Dhe kjo filozofi veprimi e prokurorit Smith kishte për qëllim, që duke i përçarë shqiptarët ta bënte më të lehtë arrestimin, mbajtjen në burg dhe dënimin e luftëtarëve. Parimi i lashtë “përçaj e sundo” edhe në këtë rast deri ditën e arratisjes funksionoi për prokurorin Smith. E gjithë ngrehina e akuzave u ndërtua mbi bazën e dokumenteve të përgatitura nga prokuroria e Serbisë, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë dhe Ministria e Mbrojtjes, duke i montuar akuzat sipas dëshirës dhe interesit të tyre.

Me gjyqet e deritanishme të zhvilluara kundër luftëtarëve të UÇK-së, është kuptuar qartë se gjykatat ndërkombëtare siç është ajo e Hagës, si dhe gjykatat në vartësi të UNMIK-ut dhe EULEX-it, kanë dështuar. Kështu që, u gjet një e quajtur gjykatë e Kosovës, që pretendon të gjejë mundësi për t'i dënua udhëheqësit e luftës. Por, edhe kjo gjykatë, që mbështetet në akuzën e ngritur nga një prokuror i arratisur, do të dështojë, prandaj është mirë që ata gjykatës të mos bien në pozitat e prokurorit Smith, nuk dua të detyrohen të arratisen nesër, prandaj i lus të bëjnë drejtësi e të mos bëjnë as politikë dhe as veprimtari mafioze kundërshqiptarë për interesat e Serbisë.

Mbajmë në vëmendje se drejtësia duhet të jetë ligjore, sepse në të kundërt kthehet në padrejtësi historike dhe politike - rrugë e cila është filluar me raportin e Dik Martit, për t'i paraqitur shqiptarët si egërsira. Ndërsa veshja me krime politike bëhet për të përçarë mbështetjen ndaj luftëtarëve, pasi ata nuk mund

të vepronin si të donin ndaj tyre nëse do të ishin shqiptarët bllok i pathyeshëm pas tyre. Kështu, zotëri Smith, “i suksesshmi”, u bë triumfator në dem të një kombi, për hatër të politikës kriminale serbe ose i paguar prej saj. Për të krijuar një ide që Serbia paska qenë në hall të madh me këta shqiptarë “kriminelë”, gjë që në opinion ia ka arritur qëllimit me ndihmën e mediave të paguara ose të papërgjegjshme të dhëna pas sensacioneve.

Prandaj, arratisja e prokurorit Smith, duhet, të paktën shqiptarëve, t'u hapë sytë. Institucionet shtetërore duhet ta vlerësojnë historinë dhe të drejtën historike të Kosovës e luftës së saj. Të gjitha institucionet në Kosovë të jenë në nivelin e detyrave të tyre kushtetuese, për të mos lënë që prokurorët si Smith dhe mbështetësit e tyre të hedhin baltë mbi historinë tonë. Duhet përfundimisht t'i dalim zot të vërtetës tonë historike dhe politike, pa prituri që të arratisen smithët e radhës.

Sot në Hagë janë fitimtarët, dhe janë të vetmit fitimtarë në botë të cilët pasi i kanë dhënë lirinë vendit të tyre janë në burg për krime të supozuara.

Arratisja e prokurorit Smith është tregues, se kjo gjykatë nuk do të ketë më tej fuqinë të ndryshoj historinë e shqiptarëve në interes të Serbisë. Kosova e ka mundur dhe zhdukur përfundimisht pushtuesin gjakatar, që bëri masakrat më të egra kundër shqiptarëve. Prandaj, prej këtej askush nuk do të mundet më ta njollosë historinë tonë. Të gjithë smithët do të arratisen, sepse e kemi historinë të kulluar si loti, e kemi luftën të ndritur e heroike.

Prandaj, ju bëj thirrje të gjithë institucioneve, të gjitha medieve, të gjithë intelektualëve, të gjithë të rinjve, të jenë në nivelin kombëtar, të demantojnë me forcë publikisht çdo tentativë që na barazon me serbët në “fajin” që paskemi bërë pse kemi luftuar për liri. Kemi vuajtur mjaft. Kush tenton të na njollos historinë duhet ta ndalim, nëse nuk e ndalim, nuk e meritojmë lirinë. Arratisja e prokurorit Smith është tregues i rëndësishëm se e drejta mund të fitojë edhe kundër organizimeve të interesave të mëdha të armiqve a të interesuarve dhe mbështetësve të tyre.

Prandaj, të bëjmë kujdes, pasi prokurori Smith, duke e ditur se për asnjë nga krimet e supozuara, nuk ka skenë krimi, se për asnjë nga krimet e supozuara nuk do të mbështetet nga provat e mbledhura në mjedisin real të asaj periudhe të luftës, ka krijuar prova të pavërteta, ka krijuar dëshmitarë të rremë, si dhe ka marrë dokumente të përgatitura nga prokuroria e Beogradit dhe institucionet tjera të Serbisë. Pra, çdo akuzë

që ka administruar prokurori i arratisur i është dhënë atij nga organet serbe, që janë pikërisht ato organe, institucione e forca të cilat kryen krime të rënda mbi popullin e Kosovës historikisht prej pushtimit të atyre trevave para një shekulli e deri në vitin 1999.

Kështu, theksoj se nuk duhet të biem në kurthin që ka ngritur prokurori i arratisur Smith, por të gjejmë fuqinë t'i tregojmë botës, se agresori dhe masakruesi i shqiptarëve, përkatësisht Serbia, nuk mund të lejohet që ta bëjë viktimën për të dënua çlirimtarët e shqiptarëve dhe të gjithë Kosovës.

Me këtë nuk them që ne tashmë duhet të fillojmë të luajmë rolin e viktimës. Jo, ne duhet të bëhemi të fortë, për të nxjerrë në shesh të vërtetën dhe të drejtën. Smithi i arratisur dhe smithët e tjerë, mund të kenë dëshirë që të krijojnë një situatë të shqiptarëve duke e megjulluar periudhën e krimeve serbe mbi shqiptarët, duke mos e parë atë si një dëshmi me vlerë për të bërë drejtësi. Por duke parë se ne që u organizuam të mos i lëmë serbët të na masakrojnë e të na zhdukin, duhet të japim llogari pse nuk u sakrifikuam për dëshirë të pushtuesit e masakruetit. Ne pra qenkemi ata që duhet të dënohemi pse luftuam dhe çliruam vendin tonë. Ky duket se është një mesazh në interes të të gjithë pushtuesve, që të bëjnë masakra, se po u ngritën të pushtuarit për të luftuar të çlirohesh, i marrim dhe i futim në burg për krime luftime. Por, a është kjo drejtësi? Duket se jo. A mund të jetë kjo vepër e shoqërive liberale? Jo dhe jo! A mbrohen kështu interesat e pushtuesve dhe masakruetit të popujve? Duket se po, prandaj ne duhet të tregojmë se nuk jemi nga ata që dorëzohemi të na masakrojnë si dele, por jemi nga ata që të gjithë mashtruesit e abuzuesit i detyrojmë të arratisen si prokurori Smith, i cili u vu kundër nesh, që besojmë se ekziston drejtësia dhe mund të bëhet drejtësi.

Kryeprokurori Jack Smith, pati deklaruar se do të merremi vetëm me krime të individëve kundër individëve. Ai deklaroi se “në asnjë mënyrë nuk jemi duke u munduar ta kriminalizojmë luftën për liri të popullit të Kosovës dhe nuk jemi këtu për ta kriminalizuar UÇK-në, sepse ne merremi vetëm me individë përgjegjës për krime”.

Por, çfarë bëri i arratisuri Smith? Nga ndjekje individuale krijoj një “organizatë të përbashkët kriminale” dhe kjo ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Duke na e bërë kështu luftën kriminale, na bën edhe lirinë kriminale, na bën edhe shtetin pjellë e krimin dhe kriminalitetit, pra Kosova nuk mund të jetë e lirë e aq më pak të jetë shtet i pavarur. Këtë e

instaloj prokurori i arratisur Smith. Por shqiptarët a do të pranojnë të jenë çfarë dëshiron zotëri Smith me serbët e Serbinë? Nëse duhet të pranohet kjo, duhet filluar duke i kërkuar falje Milosheviqit që i paskemi nxjerrë probleme me luftën çlirimtare të Kosovës. Ndërsa, në qoftë se nuk jemi dakord të kërkojmë falje Milosheviqit, duhet të ngrihem në këmbë e të kërkojmë të drejtën tonë dhe vërtetësinë historike të luftës që kemi bërë.


Kam lexuar një shkrim të dikujt ku thuhej se ju shqiptarët “nuk mund të lejoni që gjykatësit dhe avokatët ta shkruajnë historinë tuaj”. Realisht sot kjo po ndodh. Prandaj, duhet të përfitojmë nga arratisja e prokurorit Smith, për t'u thënë të gjithë atyre që duan të na përbaltin historinë: mjaft!

Ne menduam se bota e civilizuar do të na mirëkuptojë e do të japë drejtësi. Por ja që ka edhe të tillë, si prokurori i arratisur Smith, që nuk e duan drejtësinë, por duan të plotësojnë interesat e tyre dhe të atyre që kanë interesa, duke u arsyetuar se Kosova e ka krijuar vetë këtë gjykatë.

Njëkohësisht, unë nuk dua të besoj se ka të tjerë individë apo organizata e shtete, që të kenë mendësinë e prokurorit të arratisur Smith. Por, kur shikoj se Bashkimi Europian, kushtëzoi Kosovën duke e ngarkuar luftën e saj për liri me krime luftime dhe nuk ia thotë asnjë fjalë Serbisë që realisht ka kryer gjenocid në Kosovë, kuptoj se ka edhe në BE që duan të barazojnë kriminalitetin e Serbisë me atë që pretendohet se paska bërë lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. A ndihet krenar Bashkimi Evropian duke krijuar idenë se Serbia është e pastër pas gjithë gjenocidit të kryer dhe Kosova qenka kriminale, pse luftoi të çlirohej? E pra, pikërisht për të ikur prej kësaj ideje kriminale që ndërtoi, u arratis prokurori Smith.

Por, megjithatë, ne nuk duam hakmarrje, as ndëshkim, duam vetëm drejtësi. Pasi ne e dimë se nuk mund të na kthehen ata qindra mijë shqiptarë të masakruar e të zhdukur për 100 vjet. Nuk mund të na kthehen ata miliona të shpërndarë nëpër botë për të mos u kthyer më kurrë. Prandaj, kush mund të bëjë drejtësi është mik i shqiptarëve, ndërsa kush bën organizime padrejtësie kundër shqiptarëve arratiset një ditë si prokurori Smith. Megjithëse ne e dimë se çfarëdo drejtësie të bëhet nuk mund të kthejë jetën e qindramijë të masakruarve, por të paktën të njihet krimi dhe të mos ngarkohemi padrejtësisht me krim.

Zotëri prokuror Smith, ti bëre mirë që u arratis. Po çfarë duhet bërë me krimin e mashtrimin të tmerrshëm që e le në Hagë? Kjo është çështja!



Veton Zymberi, redaktor i sportit

Kosova fiton dy medalje në Kupën e Botës në Boks

Prishtinë, 20 mars - Kosova ka fituar dy medalje të bronzta nga Kupa Botërore në Boks për të Rinj U18 "Adriatic Pearl" që u mbajt në Budva nga 13 deri më 20 mars. Liberta Haxholli

(75 kg) dhe Donat Sylja (92 kg) fituan medaljet e bronzta. Ata u renditen në vendin e tretë derisa pjesëmarrës ishin 23 shtete. Drejtësinë në këtë Kupë Botërore ndau gjyqtari

ndërkombëtar Latif Demolli. Selektori Faton Xhakli dhe trajneri Nazim Halili u shprehën se nuk janë shumë të kënaqur me boksing që treguan boksierët dhe

boksieret e Kosovës, kurse kanë kërkuar të punohet maksimalisht për këtë Kampionatin Evropian U18 i cili mbahet në Jerevan (Armeni).



Giresse: Kemi ambicie për Kampionatin Evropian

"Dardanët" e futbollit kanë nisur stërvitjet për ndeshjen e parë kualifikuese në Kampionatin Evropian. Të hënën Alain Giresse ka mbajtur konferencë për medie. Ai ka thënë se Kosova synon kualifikimin në "Euro 2024", pasi grupi nuk është shumë i vështirë. "Ndodhemi në një grup i cili nuk është shumë i vështirë, por në të njëjtën kohë janë ekipe që nuk duhen nënçmuar. Por, ky grup na jep ambicie për të shkuar në Evropian", ka deklaruar strategu francez

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të shtunën e nis rrugëtimin në kualifikueset për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Përzgjedhësi i "dardanëve", Alain Giresse, të hënën në një konferencë për medie ka folur për mundësinë e Kosovës që të kualifikohet në Evropian. Sipas trajnerit francez, Kosova ka shanse për të arritur këtë synim, pasi grupi nuk është i vështirë dhe lejon të ketë ambicie të tilla. "Ndodhemi në një grup i cili nuk është shumë i vështirë, por në të njëjtën kohë janë ekipe që nuk duhen nënçmuar. Por, ky grup na jep ambicie për të shkuar në Evropian. Pra, nuk po them që është grup i lehtë, por ka mundur të jetë shumë më i vështirë. Qëllimi është ta kemi një ambicie të madhe dhe ta instalojmë atë te grupi i

lojtarëve dhe të jemi të vetëdijshëm për mundësinë që e kemi përpara", ka thënë Giresse.

Ndeshjen e parë Kosova e zhvillon ndaj Izraelit më 25 mars. Giresse nuk ka dhënë shumë detaje për këtë kundërshtar, por ka pranuar se Izraeli është një ekip i mirë sa i përket anës teknike. "Është një ekip shumë i mirë sa i përket anës teknike. Është ekip që luan futboll të bukur dhe gjithmonë tenton të ndërtojë diçka nga fillimi. Pra, nuk luan me topa të gjatë. Është ekip me lojtarë që pak a shumë kanë vlerën e njëjtë. Ka disa karakteristika të caktuara, por nuk do të flas për to sepse nuk dua që ata ta dinë për çka po flasim ne. Janë detaje që i kemi analizuar dhe nuk dua që t'u tregoj izraelitëve pikat e tyre të dobëta. Sidoqoftë, mund të them se ka lojtarë shumë të rrezikshëm siç është lojtari i Fulhamit, Manor Solomon", ka shtuar ai.



Për ndeshjet e muajit mars, Giresse ka konfirmuar mungesën e Elbasan Rashanit dhe Uran Bislimit, derisa është ftuar Blendi Idrizi. Lidhur me mungesën e anëtarit të Luganos, Uran Bislimin, foli menaxheri i Përfaqësueses së Kosovës, Bajram Shala. Ky i fundit konfirmoi se ai e ka refuzuar nëpërmjet klubit ftesën e Kosovës dhe se është në pritje të ftesës së Zvicrës. "Kosova më nuk është opsion për Uran Bislimin. Ai tri herë është ftuar, ndërsa dy herë e ka

refuzuar Kosovën. Në nëntor ishte me Kosovën, është promovuar me ne, ka shënuar gol dhe e ka puthur stemën e Kosovës, duke e konfirmuar zgjedhjen e tij. Mirëpo, pasi ka marrë ftesën dhe e ka konfirmuar fluturimin, klubi i tij, Lugano, na ka dërguar një email, ku thuhet se ai nuk dëshiron ta dëgjë mundësinë pasi është në pritje të Zvicrës. Kjo ishte hera e fundit që e kemi ftuar Bislimin dhe ai më nuk është opsion për ne", ka theksuar Shala.

Shala foli për sulmuesin Mërgim Berisha, i cili është ftuar nga Gjermania. "Mërgimin e kemi pritur katër vjet dhe kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm, madje duke i ofruar gjithçka që mund t'i ofrohet deri te detajet e pajisjes me patentë shofer të Kosovës. Por, nëse ëndrra e tij ka qenë të luajë me Gjermaninë, ajo duket se tash po i realizohet", ka deklaruar Shala, i cili ka thënë se Mërgim Berisha, Uran Bislimi dhe shumë lojtarë të tjerë po e përdorin Kosovën për të bërë presion te federatat e tjera për t'i ftuar, por ka shtuar se Kosova nuk ka kohë t'i presë derisa të dështojnë për t'u përfshirë në përfaqësueset e tjera.

Në konferencën për medie, Alain Giresse është pyetur edhe rreth mundësisë për ta ftuar në Përfaqësuesen e Kosovës Erald Krasniqin, i cili është pjesë e CFR Cluj. "Sa i përket Krasniqit, ai bën pjesë në paralistë. Ne e kemi vëzhguar dhe e vlerësojmë atë, edhe pse në Cluj është transferuar së fundmi në muajin janar. Në ditët në vazhdim mund të ketë ndryshime në listë pasi nuk e dimë gjendjen e lojtarëve pas ndeshjeve të fundjavës. Arbnor Muja, për shembull, e ka një shqetësim të vogël. Nëse hapet një mundësi, do ta ftojme Krasniqin", u shpreh Giresse. Kosova e zhvilloi të hënën edhe stërvitjen e parë në kampin nacional në Hajvali.

Cikalleshi: Në Poloni do të shkojmë për fitore

TIRANË, 20 MARS - Kombëtarja e Shqipërisë do të përballet në sfidën e parë të kualifikueseve të Evropianit përballë Polonisë. Në konferencë për medie, sulmuesi kuqezi Sokol Cikalleshi u shpreh se skuadra do të shkojë në Varshavë për ta fituar ndeshjen. "Polonia është ekipi më i fortë në grup. Duke nisur edhe nga kualifikueset e kaluara në Portugal, shpresoj ta kemi të njëjtën vazhdimësi. Nuk besoj se jam i vetëm në majën e sulmit. Duhet ta bëjmë

maksimumin si ekip. Nëse marrim rezultat pozitiv në Poloni, gjërat mund të thjeshtësohen disi. Stafit i ri i trajnerëve sapo ka ardhur. Do të ketë atë kohën e nevojshme për t'i bërë njohjet e duhura. Si ne dhe trajneri në këtë kohë të shkurtër ta bëjmë maksimumin për të shkuar në Varshavë për të bërë më të mirën. Mund të bëhet një nga ndeshjet më të vështira, por edhe një ndeshje që mund të na japë shtysën për t'u kualifikuar", ka thënë

Cikalleshi. "I kënaqur me një pikë? Pavarësisht se kush është kundërshtari në fushë, futesh për ta fituar ndeshjen. Plan B mund të jetë edhe barazimi. Unë nuk e kam menduar edhe me Francën ose Angli. Kemi shkuar për të fituar. Kemi tentuar më të mirën, pastaj ta marrim gjysmën e të keqes. Do të shkojmë për ta fituar ndeshjen dhe me grupin që kemi mendoj se mund të marrim një rezultat pozitiv", ka shtuar Cikalleshi.



Drejtuesit e KOK-ut presin në takim drejtuesit e Federatës së Çiklizmit

Prishtinë, 20 mars - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur drejtuesit e Federatës së Çiklizmit të

Kosovës, me kryetar Avni Nuha. Sipas njoftimit të KOK-ut, palët kanë biseduar për vazhdim të bashkëpunimit, me theks të veçantë garat ndërkombëtare, si Lojërat Evropiane "Krakovia 2023",

EYOF "Maribor 2023", në të cilat pritet të përfaqësohen edhe çiklistët. Kryetari Nuha, që shoqërohej nga anëtarja e BE të FÇK-së, Shqipe Miftari e Ramiz Smajli, kryetar i klubit Vjosa,

përgëzuan presidentin Krasniqi për zyrat e reja dhe e falënderuan presidentin Krasniqi për gatishmërinë për bashkëpunim në të mirë të avancimit të çiklizmit në Kosovë.



Ardian Muja, 'Ylli i javës' në Superligë

MITROVICË, 20 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, "Albi Mall", vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 26 në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Trepça '89, Ardian Muja.

Ardian Muja ishte më i miri i kësaj jave. Përveçse shënoi gol, ai kontribuoi me lojë kreative në mesin e fushës dhe bëri disa ndërprerje të kundërshtarit gjatë lojës, duke qenë më i merituari për fitoren e Trepçës '89 ndaj Dukagjinit (2:1). Këto tri pikë ia mundësuan skuadrës mitrovicase që të stabilizohet në garën për mbijetesë në elitë.

Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e FC Trepça '89, Ardian Muja, e dha Shkëlqim Cakaj, menaxher i blerjes dhe furnizimit në "Albi Mall". Muja u shpreh i lumtur për çmimin e fituar, por theksoi se në këtë edicion rëndësi kanë pikët për skuadrën, në mënyrë që sa më



herët ta sigurojë mbetjen në Superligë. "Është ndjenjë e mirë, mirëpo e rëndësishme është fitorja që e arritëm kundër Dukagjinit. Këto tri pikë janë shumë të mirëseardhura për ne për vazhdimësinë e kampionatit, duke e ditur pozitën në të cilën ndodhemi aktualisht në tabelë. Një falënderim për shokët e skuadrës për angazhimin dhe

për fitoren e kësaj jave, e ku me ndihmën dhe meritën e tyre edhe unë arrita performancë të mirë dhe në fund u vlerësua edhe si më i miri i javës. Shpresoj se kjo fitore të jetë pikë kthese për KF Trepça '89 FC dhe t'i vazhdojmë rezultatet pozitive në mënyrë që në fund ta arrijmë objektivin tonë, mbetjen në Superligë", ka theksuar Muja për faqen zyrtare të FFK-së.

Denveri dhe Milwaukee fitojnë dhe mbrojnë kreun

Milwaukee, 20 mars - Denveri rikthehet te fitorja në NBA pas fitores me rezultat 108-102 ndaj Brooklynit, duke mbrojtur kreun e renditjes në Perëndim. Porter realizoi 28 pikë e Murray 25, por protagonist ishte sërish Jokiqi me një "triple double" (22 pikë, 17 rebounde, 10 asistime). Te fitorja rikthehet edhe ekipi i lakersave, që falë 35 pikëve të Austin Reavesit, mundi me rezultat 111-105 New Orleansin. Skuadra e Milwaukee konsolidon pozitën në krye të renditjes në Lindje pas fitores me rezultat 118-111 ndaj Torontos. Për



Bucksin u dalluan Lopezi me 26 pikë e Antetokounmpo me një "triple double" (22 pikë, 13 rebounde, 10 asistime). Fitonjë edhe clippersat, që mundën me rezultat 117-102 Portlandin, ndeshje ku për miqtë shkëlqeu Paul George me 29 pikë. Zhgënjeu Phoenixi, që u mund me rezultat 124-120 nga Oklahoma, sfidë ku

për vendasit u dallua Alexander Shai me 40 pikë. Për Suns, Booker realizoi 46 pikë, por që mbetën për statistikë. Miami, falë 26 pikëve të Butlerit, mundi me shifrat 112-100 Detroitin, ndërsa San Antonio mundi me shifrat 126-118 Atlantan, ndeshje ku u dalluan Johnsoni e Vasselli me nga 29 pikë secili.

REZULTATET

Brooklyn - Denver	102-108
Oklahoma - Phoenix	124-120
San Antonio - Atlanta	126-118
Detroit - Miami	100-112
Houston - New Orleans	107-117
Milwaukee - Toronto	118-111
Portland - Clippers	102-117
Lakers - New Orleans	111-105

Ancelotti: Nëse vazhdojmë të luajmë kështu do të fitojmë një tjetër trofe

Real Madridi humbi "El Clasico"-n ndaj Barcelonës në minutat shtesë, kur shënoi Kessie për rezultatin 2-1. Edhe pse rezultati ishte negativ për "Los Blancos",

Carlo Ancelotti, në konferencë ka thënë se është krenar për ekipin e tij dhe se është i bindur se Reali me një lojë të tillë do të fitojë trofe. "Jam krenar për

ekipin tim. Jam i bindur që nëse vazhdojmë të luajmë kështu do të fitojmë një tjetër trofe. Barcelona është 12 pikë përpara sepse ka qenë konstant gjatë

sezonit. Ne paguajmë formën e janarit pas Kupës së Botës që na rrëzoi shumë në renditje. Tani po bëjmë mirë dhe mendoj se do ta përfundojmë këtë sezon mirë.

Goli i anuluar i Asensios? Nuk jam i sigurt nëse ishte pozicion jashtë loje. Nëse VAR thotë se është, atëherë kështu ka qenë", ka thënë Ancelotti.

SHKURT

Arteta lavdëron Xhakën: E ka fituar sërish besimin

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, e ka lavdëruar mesfushorin Granit Xhaka pas fitores që ka arritur skuadra londineze ndaj Crystal Palaces (4-1). "Ajo që ka ndryshuar te Granit Xhaka është se ai ka nisur ta fitojë sërish besimin. Është në vendin e duhur në fushë dhe tashmë gjendet në vendin e duhur në kohën e duhur. Para sfidës i thashë se do të shënonte sërish sepse është me mentalitetin e duhur", ka thënë Arteta. "Këtë mund ta shohësh shumë lehtë në mënyrën si po stërvitet, gjëra të mira do të vijnë për Xhakën. Për mua ai është shfaqur fenomenal për të gjithë sezonin", ka shtuar Arteta.

12 pikë para Realit, Xavi: Ende nuk ndihemi kampionë

Barcelona triumfoi në "El Clasico" përballë Real Madridit (2-1), duke hedhur kështu një hap të rëndësishëm drejt titullit kampion në La Liga, pasi ka krijuar një epërsi prej 12 pikëve. Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se edhe përkundër fitores, ende nuk ndihen kampionë. "Nuk ndihemi ende kampionë, por është një hap shumë i rëndësishëm për ne. Ndeshja ishte e përkryer dhe ne e merituarim këtë fitore. Ne ishim superiorë dhe lojtarët e meritonin këtë sukses, jo vetëm për atë që dhuruan ndaj Realit, por për të gjithë sezonin. Rezultati ishte i drejtë dhe jam i lumtur. Të gjithë vrapojnë, punojnë dhe kjo në fund sjell rezultate. Është diçka që na bën krenarë. Ne kemi regjistruar shumë pikë dhe kjo do të thotë se ekipi po punon shumë mirë. Mendoj se në këtë takim treguam jo vetëm se jemi shumë të fortë në sulm, por se jemi shumë solidë edhe në mbrojtje. Tani duhet të shohim përpara. Na presin sfida të tjera. Kampionati është ende i gjatë", ka thënë Xavi.

Nagelsmann: Tani duhet ta mposhtim Dortmundin

Gara për titull në Bundesligë ndizet fuqishëm, kjo për meritë të Bayer Leverkusenit, me "aspirinat" që thyejnë Bayern Munchenin 1-2 me përmbysje. Borussia Dortmundi shijon këtë hap fals të Bayernit duke u ngjitur në krye në kuotën e 53 pikëve, një më shumë se ekipi i Nagelsmannit. Një pjesë e mirë e titullit në Bundesligë do të luhet më 1 prill teksa Bayerni do ta presë Dortmundin. Pikërisht te kjo përballje u ndal edhe trajneri Nagelsmann pas humbjes kundër Leverkusenit. "Nuk arritëm kurrë të bënim 3-4 pasime radhazi. Ishim shumë të brishtë në fushë. E merituarim humbjen. Tani duhet ta mposhtim Dortmundin", u shpreh Nagelsmanni.

Leclerc: Jemi larg objektivave

Ferrari mbyll një tjetër fundjavë zhgënjyese, këtë herë në Arabinë Saudite. Vendi i gjashtë i Carlos Sainz dhe i shtati nga Charles Leclerc janë shumë pak për skuadrën nga Maranelo. Piloti monegask, i cili startoi nga vendi i 12, nuk mundi ta arrinte podiumin. Pas garës ai shprehu zhgënjimin e tij: "Ka shumë për të bërë, pasi jemi ende shumë larg pikës ku kërkojmë të mbërrijmë: fitores. Nuk jemi të besuar pas Bahrejnit, pasi e dinim që jemi larg rivalëve, edhe pse shpresoj se do të kishim ritëm më të mirë. Duhet të punojmë për t'i shkurtuar dallimet në pjesën e drejtë dhe në kthesa me Red Bullin dhe t'i analizojmë mirë pikat tonë të dobëta".

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "TRKS Company" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811959595 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "TRKS Company" L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811959595 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "TRKS Company" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811959595 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "STANTERG MINERALS-AG" SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810139586.

- Amir Ajko shpall te pavlefshme certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Gentual Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kIVI- IXshfmu "17 Shkurti" Hatmaxhe.

- Dardan Sadikaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Bukuriye Gjokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh. Fillore "Engjëll Jak Gjoni" Novosell e Ulët.

- Bukuriye Gjokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

